



Everest Oil Sh.A.

**Raporti i Audituesit të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2021**

PËRMBAJTJA

| | FAQE |
|--|-------|
| RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR | i-iii |
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 1 |
| PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE | 2 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO | 3 |
| PASQYRA E RRJEDHËS SË MJETEVE MONETARE | 4 |
| SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 5– 20 |



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin dhe Aksionarët e Everest Oil sha.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Everest Oil sha (më poshtë “Shoqëria”) që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 5 deri në faqen 20.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Everest Oil sha paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) bashkë me kërkesat e etikës që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

TPA Albania shpk

Rr.Ibrahim Rugova, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësim të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri material ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse

TPA Albania shpk

Rr.Ibrahim Rugova, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet në mënyre që të arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 28 Shkurt 2022

Ilir Binaj

Ilir Binaj CPA, CGMA, Auditor i Lejtar



TPA Albania shpk

Rr.Ibrahim Rugova, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Everest Oil Sh.A.

Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor, 2021

(Shumat jane të shprehuar në LEK)

| | Shenime | 31 Dhjetor, 2021 | 31 Dhjetor, 2020 |
|---|---------|-------------------|-------------------|
| Aktivet | | | |
| I. Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre | 7 | 35,426,011 | 22,080,961 |
| Llogari te arketueshme | 8 | 2,045,128 | 1,267,003 |
| TVSH e arketueshme | 9 | 4,282,706 | 13,250,474 |
| Tatim fitimi i parapaguar | | 899,664 | 899,664 |
| Total i aktiveve afatshkurtra (I) | | 42,653,509 | 37,498,102 |
| II. Aktivet afatgjata | | | |
| Aktivate afatgjata materiale | 10 | 1,211,819 | 1,446,741 |
| Aktive te afatgjata jo materiale | 11 | 643,113 | 857,484 |
| Totali i aktiveve afatgjata (II) | | 1,854,932 | 2,304,226 |
| Totali i Aktiveve (I+II) | | 44,508,440 | 39,802,328 |
| Detyrimet dhe kapitali | | | |
| I. Detyrime afatshkurtra | | | |
| Të pagueshme tregtare dhe të tjera | 12 | 7,784,162 | 6,034,050 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra (I) | | 7,784,162 | 6,034,050 |
| Totali i detyrimeve (I) | | 7,784,163 | 6,034,050 |
| II. Kapitali | | | |
| Kapitali aksionar | 13.1 | 21,000,000 | 21,000,000 |
| Rezerva përkthimi | | 8,094 | 8,094 |
| Rezerva ligjore | 13.2 | 1,244,000 | 1,244,000 |
| Rezerva për mbulimin e humbjeve | 13.2 | 13,631,920 | 13,631,920 |
| Fitim i paspërndarë | | (2,115,737) | (5,424,258) |
| (Humbja) / fitimi i vitit | | 2,956,001 | 3,308,521 |
| Totali i kapitalit (II) | | 36,724,278 | 33,768,278 |
| Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I+II) | | 44,508,440 | 39,802,328 |

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë miratuar më 25 Shkurt 2022 dhe firmosur nga:


 Administrator
 Gjergj Bojaxhi


 Pregatitur nga
 Brunilda Stefa

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 20 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Everest Oil Sh.A.

Pasqyra e performancës per vitin e mbyllur më 31, Dhjetor,2021

(Shumat jane të shprehuar në LEK)

| | Shenime | 2021 | 2020 |
|---|--------------|-------------------------------|-------------------------------|
| I. Shitjet | | | |
| Të ardhurat nga shitja | 14 | 1,810,586,361 | 1,504,158,445 |
| Të ardhura te tjera | | 83,000 | 92,929 |
| Totali i të ardhurave (I) | | <u>1,810,669,361</u> | <u>1,504,251,374</u> |
| II. Shpenzimet | | | |
| Kosto e produkteve të shitura | 15 | (1,796,284,337) | (1,487,550,524) |
| Kostot e personelit | 16 | (6,530,009) | (6,221,790) |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi | 10,11 | (541,461) | (631,490) |
| Shpenzime të tjera | 17 | (4,814,212) | (4,424,173) |
| Totali i shpenzimeve (II) | | <u>(1,808,170,018)</u> | <u>(1,498,827,976)</u> |
| Humbja) / fitimioperativ(I-II) | | <u>2,499,343</u> | <u>(3,421,467)</u> |
| III. Të ardhura financiare neto | | | |
| (Humbje) / fitim nga kurset e këmbimit neto | | 980,029 | (1,442,042) |
| Të ardhura të tjera financiare | | (523,372) | (672,834) |
| (Shpenzime) / të ardhura financiare neto (III) | 18 | <u>456,657</u> | <u>(2,114,876)</u> |
| (Humbja) / fitimi para tatimit (I-II-/+III) | | <u>2,956,001</u> | <u>3,308,521</u> |
| Tatim fitimi | 19 | - | - |
| (Humbja) / fitimi neto i vitit | | <u>2,956,001</u> | <u>3,308,521</u> |

Pasqyra e performances financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 20 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Everest Oil Sh.A.**Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto 31, 2021***(Shumat jane të shprehuar në LEK)*

| | Kapitali aksionar | Rezerva përkthimi | Rezerva ligjore | Rezerva për mbulimin e humbjeve | Fitimi i pashpërndarë | Totali |
|---|--------------------------|--------------------------|------------------------|--|------------------------------|-------------------|
| Më 31 Dhjetor, 2019 | 21,000,000 | 8,094 | 1,244,000 | 13,631,919 | (5,424,258) | 30,459,755 |
| Rritje në kapitalin aksionar (Humbja) Fitimi i vitit | - | - | - | - | - | - |
| | - | - | - | - | 3,308,521 | 3,308,521 |
| Më 31 Dhjetor, 2020 | 21,000,000 | 8,094 | 1,244,000 | 13,631,919 | (2,115,737) | 33,768,278 |
| Rritje në kapitalin aksionar (Humbja) Fitimi i vitit | - | - | - | - | - | - |
| | - | - | - | - | 2,956,001 | - |
| Më 31 Dhjetor, 2021 | 21,000,000 | 8,094 | 1,244,000 | 13,631,919 | 840,264 | 36,724,277 |

Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 20 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

| Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2021 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2020 |
|--|---|---|
| I. Rrjedha e mjeteve monetare nga veprimtaritë operative | | |
| (Humbja) / fitimi para tatimit | 2,956,001 | 3,308,521 |
| <i>Rregullime për:</i> | | |
| Zhvlerësimindhe amortizimin | 10,11 541,461 | 631,490 |
| Kosto Financiare neto | 18 523,372 | 672,834 |
| | 4,020,833 | 4,612,845 |
| <i>Ndryshime ne kapitalin punues:</i> | | |
| Rënie/(rritje) në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera | 8,189,643 | 356,788 |
| Rënie / (rritje)në inventar | | |
| Rënie në mjete monetare të mbajtura si garanci bankare | | |
| Rënie në të pagueshme tregate e të tjera | 1,750,112 | (107,457) |
| | 13,960,588 | 4,862,176 |
| Interes i paguar | (523,372) | (672,834) |
| Tatim fitimi i paguar | - | (17,929) |
| Fluksi i mjeteve monetare neto të përdorur në veprimtarite e shfrytezimit | 13,437,216 | 4,171,412 |
| II. Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit | | |
| Blerje e aktivete afatgjata material dhe jo-materiale | (92,167) | (262,756) |
| Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata material | | |
| Fluksi monetar neto i perdorur ne veprimtarite investuese | (92,167) | (262,756) |
| III. Flukse monetare nga veprimtarite financuese | | |
| Rritje Kapitali | | |
| (Pagesa)/ Arkëtime nga financime afatshkurtra | | - |
| Dividentë të paguar | | |
| Fluksi i mjeteve monetare neto të përdorur në veprimtaritë financuese | | - |
| IV.. Rënie neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre | | |
| | 13,345,049 | 3,908,656 |
| V. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit | | |
| 7 | 22,080,961 | 18,172,305 |
| VI. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit | | |
| 7 | 35,426,011 | 22,080,961 |

Pasqyra e rrjedhës së mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 20 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Everest Oil Sh.A. (“Shoqëria”) u themelua më 29 qershor 2012 me NIPT L21829002Q. Shoqëria vepron në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14 prill 2009 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjin nr. 8450, datë 24 shkurt 1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë më 31 Dhjetor, 2021 is Lek 21,000,000 (2020: Lek 21,000,000). Objektivi kryesor i Shoqërisë është të ofrojë produkte të hidrokarbureve të cilësisë së lartë në tregun shqiptar dhe të funksionojë si një importues ekskluziv i produkteve të hidrokarbureve, si dhe shitjen me shumicë të tyre, pikave të karburantit dhe klientëve. Për këtë shoqërisë i është dhënë licenca me numër LN5440-07-2012 në datë 18 korrik 2012 nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL). Gjatë vitit 2013, Shoqërisë i është dhënë licenca nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) me numër LN5440-07-2012 datë 2 maj 2013 për të funksionuar si importues i gazit dhe për të kryer shitjen me shumicë të tij nëpër pikat e karburantit dhe klientëve.

Më 31 dhjetor, 2021 dhe 2020, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë janë Paolo Ghinassi, Krenar Loloçi dhe Gjergj Bojaxhi sic janë prezantuar në Ekstartkin e Qendrës Kombëtare të Biznesit 26 Shkurt, 2021.

Shoqëria është regjistruar si tatimpagues në Njësinë e Tatimpaguesve Tiranë dhe në 1 prill 2015 ka kaluar në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me numër indentifikimi (NIPT) L21829002Q. Adresa e saj e regjistruar është Rr. Lidhja e Prizrenit, Pallati Vega (no.8), Kati V, Apartament no.15, Tirane, Albania. Numri mesatar i punonjësve per vitin, 2021 është 4 (per vitin , 2020: 4).

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare te Kontabilitetit të (referuar ketej e tutje si SKK) dhe bazuar në Ligjin nr 25/2018 date 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare “ dhe në përputhje me politikat e grupit. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke respektuar parimin e kostos historike dhe parimin e vijmësisë. Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerisë.

2.1 Standarte, ligje, interpretime dhe amendime te reja efektive në periudhën aktuale

Politikat kontabel te adaptuara jane konsistente me ato te vitit te meparshem dhe Keshilli Kombetar i Kontabilitetit nuk ka nxjerre permisime te Standarteve kombetare te Kontabilitetetit (SKK) te cilat jane efektive ne daten e leshimit te Pasqyrave Financiare te Kompanise.

3. BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

4. MONEDHA FUNKSIONALE

Keto pasqyra financiare individuale jane paraqitur ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise.

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

6.1 Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhë të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës financiare. Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

| | 31 Dhjetor,2021 | 31 Dhjetor,2020 |
|-----------------|------------------------|------------------------|
| US Dollar (USD) | 106.54 | 100.84 |
| Euro (EUR) | 120.76 | 123.70 |

6.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 7.

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

6. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

6.2 Instrumentat financiarë (Vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivitetet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi

6.4 Aktive afatgjata materiale

i Njohja dhe matja

Aktivitetet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e performancës financiare

ii. Kosto vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktiveve afatgjata material është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës, në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e performancës financiare kur ndodhin.

6. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

6.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Aktivitet e marra me qira amortizohen me metodën lineare duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet. Toka nuk amortizohet. Të gjitha aktivitet e tjera amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur, rishikohen në çdo datë të pasqyrave financiare.

Metodat e amortizimit dhe norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

| Kategoria e aktivitet | Norma e amortizimit |
|------------------------------|----------------------------|
| Mobilje zyre | 20% |
| Pajisje informatike | 25% |
| Mjete transporti | 20% |

6.5 Zhvlerësimi

i. Aktivitet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitet dhe që kanë patur një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitet financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

ii. Aktivitet jo-financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të pritshme skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitet për të cilat parashikimet e flukseve të ardhshme monetare nuk janë rregulluar. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktivitet tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës financiare.

6.6 Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

6.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e performancës financiare në përputhje me SKK 8 “Të ardhurat”. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me arkëtimin e pagesës dhe matjen e kostove përkatëse. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur janë plotësuartë gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave;
- Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në manaxhimin e mallrave në atëmasë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë; si dhenuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësi ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

6.8 Të ardhurat nga shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës financiare me metodën e interesit efektiv.

6.9 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e performancës financiare. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t’u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

7. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si vijon:

| | Më 31 dhjetor, 2021 | Më 31 dhjetor, 2020 |
|------------------|------------------------|------------------------|
| Gjendja në arkë | 1,335,523 | 291,147 |
| Gjendja në bankë | 34,090,488 | 21,789,813 |
| <i>LEK</i> | 2,463,167 | 8,214,421 |
| <i>Euro</i> | 338,441 | 219,822 |
| <i>USD</i> | 31,288,880 | 13,355,570 |
| TOTAL | 35,426,011 | 22,080,961 |

8. TË ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si vijon:

| | Më 31 dhjetor, 2021 | Më 31 dhjetor, 2020 |
|---|------------------------|------------------------|
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 3,740,091 | 2,804,277 |
| Fond zhvlerësimi për llogari të arkëtueshme | (2,433,345) | (2,433,345) |
| | 1,306,746 | 370,932 |
| Parapagime | 662,147 | 730,742 |
| Të arkëtueshme të tjera | 69,105 | 165,328 |
| Shpenzime të shtyra | 7,130 | |
| TOTAL | 2,045,128 | 1,267,003 |

Zhvlerësimi për llogarinë të arkëtueshme lidhet me balancën ndaj Enerco LLC në shumën Lek 2,433,345 që u provigjonuan gjatë vitit 2017.

9. TVSH E ARKËTUESHME

Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria ka TVSH të rimbursueshme në vlerën Lek 4,282,706 (2020 Lek 13,250,474). Gjate vitit 2021 Shoqëria është rimbursuar pjesërisht nga Zyra e Tatim Taksave në shumën 9,061,656 lek si rezultat i vendimit nr 205 datë 30.01.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë në favor të Shoqërisë. Pjesa e mbetur në shumën 1,239,784 Lek do të kompensohet me tatimin mbi të ardhurat personale në bazë mujore sipas vendimit nr 963/2 datë 28/07/2021 të Drejtorisë së Apelitimit Tatimor dhe në bazë të Ligjit për Procedurat Tatimore.

Shuma Totale e TVSH së rimbursueshme më 31.12.2021 në vlerën Lek 4,282,706 mund të ndahet në një pjesë që përfaqëson shumën e akumuluar për periudhën Prill 2018 deri 31 Dhjetor 2021 në vlerën Lek 2,670,273 e cila nuk është audituar nga zyra e taksave, dhe pjesa tjetër në shumën Lek 1,612,433 e audituar nga zyra e tatim taksave por që vetëm shuma Lek 1,239,784 është njohur për kompensim dhe pjesa e mbetur mbetet të sqarohet me zyrën e tatim taksave.

Everest Oil sh.a.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)***10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si vijon:

| | Mjete transporti | Mobilje zyre | Pajisje zyre dhe informatike | TOTALI |
|-------------------------------------|------------------|----------------|------------------------------|------------------|
| Kosto | | | | |
| Gjendja më 1 janar , 2020 | 3,438,925 | 575,007 | 1,636,594 | 5,650,526 |
| Shtesa | - | - | 92,167 | 197,492 |
| Pakësime | - | - | - | - |
| Gjendja më 31 Dhjetor, 2020 | 3,438,925 | 575,007 | 1,926,253 | 5,848,018 |
| Shtesa | - | - | 92,167 | 92,167 |
| Gjendja më 31 Dhjetor, 2021 | 3,438,925 | 575,007 | 1,926,253 | 5,940,185 |
| Amortizim i akumuluar | | | | |
| Gjendja më 1 janar, 2020 | 2,481,088 | 422,554 | 1,142,938 | 4,046,580 |
| Zhvleresim I vitit | 191,567 | 29,705 | 133,424 | 354,696 |
| Pakësime | - | - | - | - |
| Gjendje më 31 Dhjetor , 2020 | 2,672,655 | 452,259 | 1,276,362 | 4,401,276 |
| Zhvlerësim i vitit | 153,254 | 23,764 | 150,072 | 327,090 |
| Gjendje më 31 Dhjetor , 2021 | 2,825,909 | 476,023 | 1,426,434 | 4,728,366 |
| Vlera neto kontabël | | | | |
| Më 31 Dhjetor, 2020 | 766,270 | 122,748 | 557,724 | 1,446,741 |
| Më 31 Dhjetor, 20201 | 613,016 | 98,984 | 499,819 | 1,211,819 |

Deri më 31 dhjetor 2021, nuk ka aktive afatgjata materiale të vendosura si kolateral (2020 asnjë)

11. AKTIVET AFATGJATA JO MATERIALE

ktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si vijon

| | Software | Total |
|------------------------------------|------------------|------------------|
| <i>Kosto</i> | | |
| Gjendja më 1 janar, 2020 | 3,558,471 | 3,558,471 |
| Shtesa | 65,265 | 65,265 |
| Gjendja më 31 Dhjetor, 2020 | 3,623,736 | 3,623,736 |
| Shtesa | | |
| Gjendja më 31 Dhjetor, 2021 | 3,623,736 | 3,623,736 |
| <i>Amortizimi i akumuluar</i> | | |
| Gjendja më 1 janar, 2020 | 2,489,458 | 2,489,458 |
| Amortizimi i vitit | 276,793 | 276,793 |
| Gjendja më 31 Dhjetor, 2020 | 2,766,251 | 2,766,251 |
| Amortizimi i vitit | 214,371 | 214,371 |
| Gjendja më 31 Dhjetor, 2021 | 2,980,622 | 2,980,622 |
| <i>Vlera neto kontabël</i> | | |
| Më 31 Dhjetor, 2020 | 857,484 | 857,484 |
| Më 31 Dhjetor, 2021 | 643,114 | 643,114 |

12. TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Të pagueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si vijon:

| | Më 31 Dhjetor 2021 | Më 31 Dhjetor 2020 |
|----------------------------------|-----------------------|-----------------------|
| Parapagime të marra nga klientët | 5,232,269 | 3,598,688 |
| Të pagueshme tregtare | 2,371,615 | 2,247,310 |
| Të pagueshme ndaj shtetit | 180,279 | 174,469 |
| Shpenzime të përlogaritura | - | 13,583 |
| TOTAL | 7,784,163 | 6,034,050 |

Parapagimet i referohen pagesave të marra nga klientët e Shoqërisë për të cilët shërbimi nuk është ofruar ende deri në datën e raportimit.

Të pagueshme ndaj shtetit përmbajnë detyrimet për sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)***13. KAPITALI AKSIONAR****13.1 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i regjistruar i Shoqërisë deri më 31 Dhjetor, 2021 është Lek 21,000,000 (31 Dhjetor, 2020 Lek 21,000,000) dhe përbëhet nga 2,100 aksione (2020: 2,100 aksione) me një vlerë nominale prej Lek10,000 (2020: Lek10,000).

| | Më 31 Dhjetor, 2021 | | Më 31 Dhjetor, 2020 | |
|----------------|---------------------|-------------------|---------------------|-------------------|
| | Në % | Në vlerë | Në % | Në vlerë |
| Petra S.R.L. | 52.43% | 11,010,000 | 52.43% | 11,010,000 |
| Valerio Andrea | 18.00% | 3,780,000 | 18.00% | 3,780,000 |
| Gjergj Bojaxhi | 10.00% | 2,100,000 | 10.00% | 2,100,000 |
| Jola Bojaxhi | 10.00% | 2,100,000 | 10.00% | 2,100,000 |
| Oltion Spiro | 9.60% | 2,010,000 | 9.60% | 2,010,000 |
| TOTAL | 100% | 21,000,000 | 100% | 21,000,000 |

13.2 Rezerva ligjore

Rezerva ligjore prej Lek 1,244,000 (2020: Lek 1,244,000) perfaqeson ndarjen e një pjese te fitimit te pashperndare ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14 prill 2018, "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

14. TË ARDHURA NGA SHITJA

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021/2020 përbëhen si vijon:

| | Më 31 Dhjetor, 2021 | Më 31 Dhjetor, 2020 |
|-------------------|----------------------|----------------------|
| Shitja e Naftës | 1,417,297,441 | 1,225,141,534 |
| Shitja e benzinës | 390,309,430 | 277,475,920 |
| Shitje Gazi | 2,979,490 | 1,540,990 |
| Te tjera shitje | 83,000 | 92,929 |
| TOTAL | 1,810,669,361 | 1,504,251,374 |

15. KOSTO E PRODUKTEVE TË SHITURA

Kosto e produkteve të shitura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021/2020 përbëhet si vijon:

| | Më 31 Dhjetor 31, 2021 | Më 31 Dhjetor 31, 2020 |
|-----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Kosto e produkteve dhe shërbimeve | 1,796,284,337 | 1,487,550,524 |
| TOTAL | 1,796,284,337 | 1,487,550,524 |

16. SHPENZIME PERSONELI

Kostot e personelit përbëhen nga pagat dhe shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore:

| | Më 31 Dhjetor , 2021 | Më 31 Dhjetor, 2020 |
|-----------------------------------|----------------------|---------------------|
| Pagat e personelit | 5,889,640 | 5,633,854 |
| Sigurime shoqërore e shëndetësore | 640,369 | 587,936 |
| TOTAL | 6,530,009 | 6,221,790 |

17. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera përbëhen si vijon:

| | Më 31 Dhjetor , 2021 | Më 31 Dhjetor, 2020 |
|-----------------------------------|----------------------|---------------------|
| Shërbime laborator | 1,440,000 | 1,595,000 |
| Shpenzime konsulence | 1,238,956 | 1,046,311 |
| Shpenzime qeraje | 640,781 | 644,139 |
| Shpenzime përfaqësimi | 328,040 | 161,060 |
| Shpenzime të tjera | 265,211 | 274,764 |
| Taksa të tjera | 201,096 | 198,052 |
| Shpenzime postare e komunikacioni | 194,070 | 180,176 |
| Shpenzime te tjera shtetërore | 180,000 | - |
| Karburant | 155,755 | 124,400 |
| Mirëmbajtje | 98,377 | 80,050 |
| Shpenzime utilitare | 45,666 | 56,361 |
| Siguracion | 22,760 | 46,185 |
| Gjoha e dëmshpërblime | 3,500 | 17,674 |
| Total | 4,814,212 | 4,424,173 |

18. TË ARDHURA FINANCIARE NETO

Të ardhurat financiare neto përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 Dhjetor , 2021 | Më 31 Dhjetor, 2020 |
|------------------------------|----------------------|---------------------|
| Fitime nga kurset e këmbimit | 980,029 | (1,442,042) |
| Shpenzime financiare neto | (523,372) | (672,834) |
| TOTAL | 456,657 | (2,114,876) |

19. TATIM FITIMI

Në përputhje me legjislacionin shqiptar tatim fitimi i aplikueshëm për 2021 është 15% (2020 ;15%).

Tatim fitimi efektiv për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2021 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2020 |
|---------------------------------------|--|--|
| (Humbja) / fitimi para tatimit | 2,956,001 | 3,308,521 |
| Shpenzimet e pazbritshme | 125,506 | 180,464 |
| Humbje tatimore te mbartura | (3,081,507) | (3,488,985) |
| Fitim (Humbjet) e vitit aktual | - | - |

Humbje e akumuluar mund te mbartet deri tre vite te njepasnjeshme. Humbja e akumuluar eshte detajuar si me poshte:

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2021 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2020 |
|---|--|--|
| Humbje tatimore nga 2017 qe mbartet deri 2020 | - | (5,318,107) |
| Humbje tatimore nga 2019 qe mbartet deri 2022 | (1,435,060) | (4,516,567) |
| Fitim (Humbjet) e vitit aktual | (1,435,060) | (9,834,673) |

20. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA*Angazhimet*

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtezuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

Angazhimet per qerane financiare

Shoqëria nuk ka angazhime të anulueshme në lidhje me qiranë operative.

Detyrimet tatimore

Librat dhe regjistrimet per tatimet të Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021 nuk jane kontrolluar nga autoritetet tatimore. Si pasojë, detyrimet tatimore të Shoqërisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara. Tatimet shtesë që mund të lindin në rast të kontrollit tatimor nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme

Ceshtjet gjyqesore

Me 31 Dhjetor 2021, nuk ka ceshtje gjyqesore te ngritur kunder Shoqërisë

21. PALËT E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një influencë të ndjeshme mbi palën tjetër, ose kur kanë kontroll të përbashkët të një njësie tjetër ose kur është anëtar i personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është pushteti për të drejtuar politikën financiare dhe operacionale të një shoqërie në mënyrë që të marrësh përfitime nga aktiviteti i saj. Kontrolli ekziston kur mëma, direkt ose indirekt, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votave, të shoqërisë bijë.

Kompensimet e Drejtuesve Kryesore

Kompensimet e Drejtuesve Kryesore duke përfshirë pagat dhe shpërblimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 31, 2021, janë Lek 3,990,900 (2020: Lek 3,822,871).

22. MANAXHIMI RREZIKUT FINANCIAR**(a) Rreziku likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të ndeshet me vështirësi në ngritjen e fondeve për të përmbushur angazhimet e lidhura me instrumentat financiare. Shoqëria monitoron likuiditetet e veta periodikisht në mënyre që të manaxhojë detyrimet e veta kur ato duhen paguar.

Aktivitet financiarë që sjellin interes kanë të bëjnë me llogari rrjedhëse dhe depozita afatshkurtra në banka.

Tabela e likuiditeteve më poshtë është hartuar në bazë të maturimeve kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare.

| | Më pak se 6 muaj | 6 - 12 muaj | Mbi 12 muaj | Total |
|----------------------------|-------------------------|--------------------|--------------------|------------------|
| Llogari të pagueshme | 2,622,400 | - | 5,161,762 | 7,784,163 |
| Më 31 Djeter, 2021 | 2,622,400 | - | 5,161,762 | 7,784,163 |
| | Më pak se 6 muaj | 6 - 12 muaj | Mbi 12 muaj | Total |
| Llogari të pagueshme | 1,612,231 | - | 4,412,820 | 6,034,050 |
| Më 31 Dhjetor, 2020 | 1,612,231 | - | 4,412,820 | 6,034,050 |

24. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i tregut*****Ekspozimi ndaj rrezikut të valutës së huaj***

Rreziku i valutes se huaj eshte rreziku qe vlera e instrumentave financiare do te luhetet nga ndryshimet ne kurset e kembimit te monedhave te huaja. Ekspozimet e shoqerise ndaj rrezikut te kembimit valuator krijojne fitime dhe humbje ne valute te huaj qe njihen fitime ose humbje. Keto ekspozime perfshijne te arketueshme dhe detyrimet minetare te Shoqerise te cilat nuk jane te shprehura ne monedhen matese te Shoqerise. Analiza e pozicioneve monetare me 31 dhjetor, 2021 dhe 2020, sipas monedhave te huaja ne te cilat ato ishin te shprehura ishin si me poshte:

| | EUR | USD | LEK | Total |
|--|------------------|-------------------|------------------|-------------------|
| Të arketueshme tregtare | 240,011 | 3,807,304 | (2,002,187) | 2,045,128 |
| Mjete Monetare dhe ekuivalente të tyre | 993,253 | 31,395,585 | 3,037,172 | 35,426,011 |
| Totali i aktiveve | 1,233,264 | 35,202,890 | 1,034,985 | 37,471,139 |
| Trade payable | 956,505 | 6,390,945 | 436,713 | 7,784,163 |
| Totali i detyrimeve | 956,505 | 6,390,945 | 436,713 | 7,784,163 |
| Më 31 Dhjetor, 2021 | 276,759 | 28,811,945 | 598,272 | 29,686,976 |

| | EUR | USD | LEK | Total |
|--|----------------|-------------------|------------------|-------------------|
| Të arketueshme tregtare | 172,347 | 429,304 | 665,352 | 1,267,003 |
| Mjete Monetare dhe ekuivalente të tyre | 274,551 | 13,425,306 | 8,381,103 | 22,080,961 |
| Totali i aktiveve | 446,898 | 13,854,610 | 9,046,455 | 23,347,963 |
| Të pagueshme tregtare | 245,626 | 5,352,832 | 435,592 | 6,034,050 |
| Totali i detyrimeve | 245,626 | 5,352,832 | 435,592 | 6,034,050 |
| Më 31 Dhjetor, 2020 | 201,272 | 8,501,778 | 8,610,863 | 17,313,914 |

24. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj rrezikut të valutës së huaj (vazhdim)***Analiza e ndjeshmerise së rrezikut të kursit të këmbimit*

Analiza e mëposhtme në lidhje me rrezikun e këmbimit valuator bazohet ne ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në datën e raportimit dhe në ndryshimet e bëra në fillim te vitit financiar që mbeten konstante gjate periudhës raportuese. Më poshtë paraqitet ndikimi i luhatjeve të kursit. të këmbimit në tatimin pas fitimit kure të gjitha variablat e tjera mbeten konstante. Tabela në vijim tregon fitimin/(humbjen) ne Lekë kur Euro dhe Dollari Amerikan (USD) ulen 10% kundrejt Lekut :

| Zhvlerësim i monedhë | 2021 | | 2020 | |
|----------------------|--------|-----------|--------|---------|
| | EUR | USD | EUR | USD |
| By 10% | 27,676 | 2,881,194 | 20,127 | 850,178 |

c) Rreziku kreditor

Rreziku Kreditor është rreziku i humbjes financiare të Shoqërise nëse një klient ose një pale tjetër e një instrumenti financiar dështon të përmbushë detyrimet esaj kontraktuale që rrjedhin kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme te Shoqërisë, TVSH-ja e arkëtueshme dhe mjetet monetare në bankë.

| | 31 Dhjetor 2021 | 31 Dhjetor 2020 |
|----------------------------|-------------------|-------------------|
| Të arketueshme tregtare | 2,045,128 | 1,267,003 |
| TVSH e Arkëtueshme | 4,282,706 | 13,250,474 |
| Llogari rrjedhëse ne Bankë | 34,090,488 | 21,789,813 |
| | 40,418,322 | 36,307,290 |

Levizjet në provizionin për zhvlerësim në lidhje me llogarite e arketueshmet e te tjera te arketueshme gjatë vitit ishin si me poshte:

| | 31 Dhjetor 2021 | 31 Dhjetor 2020 |
|-----------------------|------------------|------------------|
| Gjendja me 1 janar | 2,433,345 | 2,433,345 |
| Humbja nga zhvlersimi | - | - |
| Gjendja me 31 Dhjetor | 2,433,345 | 2,433,345 |

Everest Oil sh.a.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

23. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme të cilat kërkojnë rishikime ose ndryshime në këto pasqyra financiare.